



Shqipëria, CEFTA-s dhe krijimi i një zone të tregtisë së lirë

Në kuadër të integritit rajonal, Shqipëria fillimisht u përfshi në marrëveshje bilaterale të tregtisë së lirë me vende të rajonit, të cilat konvergjuan në marrëveshjen CEFTA 2006, e nënshkruar në 19 dhjetor 2006, në Bukuresht, Rumani. Qëllimi kryesor i CEFTA-s ishte krijimi i një zone të tregtisë së lirë midis vendeve nënshkruese, cka nënkuptonte zgjerimin dhe përshpejtimin e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, tërheqjen dhe nxitjen e investimeve të huaja direkte, eliminimin e barrierave në tregtinë ndërmjet palëve, harmonizimin e rregullave të konkurrencës, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe integrimin e rajonit në tregtinë globale.

Procesi i integritit rajonal në kuadër të CEFTA, përveç përfitimeve të drejtpërdrejta për vendet anëtare dhe për rajonin në tërësi, funksionon edhe si një urë lidhëse që përshpejton edhe integrimin evropian të secilit nga vendet anëtare. Anëtare të CEFTA 2006 janë: Shqipëria, Bosnie dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mal i Zi, Serbia, Kosova dhe Moldavia.

Në 1 janar 2019, Shqipëria mori kryesinë e CEFTA. Komuniteti i Biznesit e cilësoi këtë mundësi si një avantazh për të influencuar më shumë në eliminimin dhe zbutjen e barrierave tregtare, kryesisht atyre jotarifore mes vendeve anëtare, me impakt nxitjen e tregtisë rajonale. Rreth 25% e tregtisë së CEFTA-s është tregti ndërrajonale dhe rreth 75% për pjesën tjetër të botës, kryesisht për tregjet në BE. Statistikat në 2019 tregojnë se shkëmbimet tregtare midis Shqipërisë dhe vendeve të CEFTA-s tejkaluan vlerën e 750 milion euro, në të cilat pesha e importeve arrin në 40 % dhe e eksporteve në 60 %. Trendi pozitiv i shkëmbimeve tregtare në vitet 2014-2018 ka pësuar një rritje të përvitshme mesatare në nivelin prej 6%.

Gjatë javës së CEFTA në dhjetor 2019 në Tiranë, Komisioni Europian firmosi Grantin prej 10 mln Euro për anëtarët e CEFTA, me qëllim nxitjen e mëtejshme të integritit ekonomik rajonal. <https://www.adbc.al/shqiperia-cefta-s-dhe-krijimi-i-nje-zone-te-tregtise-se-lire/>

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



Sipërmarrësja Saranda Iseni: Është koha të fokusohemi te potencialet që ofron Shqipëria

Sarada Iseni u largua nga vendlindja e saj rreth dy dekada më parë për të provuar veten në Suedi. Sot ajo është një juriste dhe sipërmarrëse. Për dy vite ajo ka drejtuar Rrjeti i Bizneseve të Diasporës Shqiptare në Suedi, degë e Rrjetit Global të Bizneseve të Diasporës Shqiptare i cili aktualisht ka degët e tij në rreth 30 shtete në mbare botën.

Për të krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare është mundësia e kërkuar prej kohësh nga sipërmarrësit shqiptar nëpër botë, jo vetëm si një pikë takimi por edhe si një vend të cilin mund ta quajnë plotësisht Shtëpia e tyre në Shqipëri.

Znj. Iseni sa i rëndësishëm është bashkimi i Bizneseve të Diasporës Shqiptare në këtë moment?

Faktikisht është shumë i rëndësishëm pasi momentalisht ndodhemi në vllugun më të madh të zhvillimit ekonomik. Mendoj se brenda shumë pak kohe, ndoshta brenda pesë viteve të ardhshme Ballkani, veçanërisht Shqipëria dhe Kosova do të jenë furnizuesit më të mëdhenj në Evropë, jo vetëm për sa i përket produkteve, prodhimeve të ndryshme, por pse jo edhe sipërmarrjeve.

Rrjeti i Bizneseve të Diasporës Shqiptare është një strukturë që ka degë në shumë vende të botës, ju keni drejtuar për dy vite (2015-2017) degën e Suedisë. Si funksionon kjo strukturë?

Është një ndër iniciativat më të mira që është bërë tek komuniteti jonë shqiptar, sepse ne jemi të njohur për individualizmin tonë, të fortë sa nuk ka fund. Por më në fund erdhi një iniciativë që ne bashkarisht të bëhemi më të fuqishëm. Nga përvoja 2 vjeçare e imja mund të them se është një ndër përvojat më frytdhënëse që kam pasur. Për sa i përket njohjes së njëri-tjetrit, por dhe njohurive se çfarë bëjnë njerëzit tanë e çfarë mendimesh kanë, çfarë dëshirash kanë, çfarë përvojash kanë në vendlindje për shembull, ku pjesa më e madhe kanë arritje jashtëzakonisht të mëdha. [...]

Intervista e plotë: <https://www.adbc.al/sipermarresja-saranda-iseni-eshte-koha-te-fokusohemi-te-potencialet-qe-ofron-shqiperia>



Holandë: Mbrëmje muzikore me kryeveprat e muzikës shqiptare për rindërtimin e muzeut "Shtëpia me gjethe"

[> Link <](#)



Kryeministri paralajmëron amnisti fiskale: Paratë të gjitha nëpër bankat këtu, edhe emigrantët. Kush përjashtohen, nga unë i pari do japim llogari

[>Link <](#)

Java në lajme



Deutsche Welle: Do të perëndojë globalizimi nga një virus? Efektet në ekonomi

[> Link <](#)



Banka Botërore: Kujdes me projektet për rindërtimin, ndikojnë te rritja ekonomike dhe borxhi

[> Link <](#)

Dy vendime qeverie



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

Këshilli i Ministrave ka miratuar në mbledhjen e radhës më datë 26 shkurt vendimin për Miratimin e kontratës me ndarje prodhimi, e ndryshuar dhe e riformuluar, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku "2-3", ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë (e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore/AKBN) dhe "Shell Upstream Albania B.V".

Gjithashtu u miratua edhe vendimi miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e projektit "Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës", ratifikuar me ligjin nr.50/2016.

Këto dhe vendime të tjera mund ti lexoni të plota këtu:

<http://www.news.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratua-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-26-shkurt-2020/>

Kursi zyrtar i këmbimit



Dollar Amerikan	USD	110.78	-0.60
Euro	EUR	122.74	0.00
Poundi Britanik	GBP	141.63	-1.89
Franga Zvicerane	CHF	115.30	-0.19
Jeni Japonez (100)	JPY	102.76	+0.32
Dollari Australian	AUD	72.62	-0.03
Dollari Kanadez	CAD	83.05	+0.23

Rreth Dhomës së Biznesit për Diasporën Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është organizata e parë në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse, ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë dhe të nxisim bizneset e të gjitha madhësive për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.



Numrin e radhës të revistës Monitor mund ta lexoni këtu : www.monitor.al



Gazetën Çelësi mund ta lexoni këtu: <http://www.yellowpagesalbania.com>

